

PREPORTR

LLUMI JONË

Deponitë rajonale të mbeturinave në Kosovë u ndërtuan pa asnjë studim dhe pa konsultim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Besnik Boletini (2-5)

LUMENJTË E “VDEKUR”

Mbrojtja e lumenjve nuk ka qenë prioritet për Qeverinë e Kosovës. Besa Kalaja (6-8)



Deponitë rajonale të mbeturinave në Kosovë u ndërtuan pa asnjë studim dhe pa konsultim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Edhe përkundër investimit të dhjetëra miliona eurove, gjendja e këtyre deponive nuk është e mirë, ndërsa ka nga ato deponi që janë në gjendje tepër të keqe, rrezikojnë jetën e njerëzve dhe ndotin ambientin, duke përfshirë edhe ujërat nëntokësore. Duke marrë parasysh këtë gjendje, asnjëra nga deponitë nuk i kanë plotësuar kushtet për leje mjedisore nga MMPH. Këto deponi pranojnë vetëm mbeturina sanitare, ndërsa nuk kanë kapacitete për të pranuar mbeturina tjera, si ato elektronike, goma, mbeturina shtazore etj, edhe pse këto të fundit shpesh përzihen me mbeturina sanitare dhe dërgohen nëpër deponi, ashtu siç dërgohen shpesh edhe mbetjet e mbeturinave medicinale.

LLUMI JONË

BESNIK BOLETINI

Përkundër investimeve të mëdha që deri tani kapin vlerën mbi 23 milionë euro, gjendja e deponive të mbeturinave rajonale të Kosovës është jo e mirë. Këto deponi shërbejnë vetëm për mbeturina sanitare dhe nuk kanë kapacitete që të trajtojnë mbeturinat e tjera si gomat, eshtrat e shtazëve, e të mos flasim për mbeturina më të rrezikshme. Duke marrë parasysh shumën e mjeteve financiare të investuara në këto deponi, gjendja e tyre është dashur të jetë shumë më e mirë, bile dhe nga to pas disa viteve të arrihen edhe përfitime përmes nxjerrës së gazit që mblidhet në mbeturina, gjë që e bëjnë shumë vende tjera. Në deponitë më të mëdha të Kosovës jo që nuk ekziston një

mundësi e tillë, por ka deponi, siç është ajo e Mirashit, që nuk i ka as gypat e ventilimit për ta nxjerrë jashtë gazin e mbledhur në mbeturina, në mënyrë që të shmangë rrezikun nga ndonjë shpërthim i mundshëm i zjarrit.

Duke marrë parasysh, që vetëm disa nga mbeturinat riciklohen aktualisht në Kosovë, deponitë pranojnë një sasi të madhe të mbeturinave. Sipas drejtuesve të KMDK-së, mesatarja në ton e mbeturinave në vit është: Mirash-Prishtinë 89.000 ton, Dumnicë-Podujevë 8.000 ton, Landovicë-Prizren 59.000 ton, Gërllicë-Ferizaj 14.000 ton dhe Velekincë-Gjilan 36.000 ton. Sipas drejtuesve të deponive, ngecje në punë dhe vonesa në trajtimin e mbeturinave shpesh shkaktojnë edhe pajisjet e vje-

tra, të cilat duhet të riparohen shpesh, pra nuk ka investime në makineri të re. Ndërsa, në anën tjetër, borxhi total që i kanë kompanitë e kontraktuara KMDK-së është mbi 2 milionë e 900 mijë euro.

DEPONITË NUK KANË LEJE MJEDISORE!

Ndërtimi i deponive rajonale është bërë nga BE-ja dhe ka kushtuar mbi 10 milionë euro. Por, përkundër këtij investimi, asnjë nga deponitë nuk i plotëson kriteret për t'u pajisur me leje mjedisore. Sipas Muhamet Malsiut, drejtor i departamentit për mbrojtjen e mjedisit në MMPH, këto deponi janë ndërtuar pa u bërë një studim i mirëfilltë dhe pa u konsultuar me këtë ministri.

“Asnjë nga deponitë nuk ka marrë leje të integruar mjedisore

që do të duhej ta kishin, e të cilat janë paraparë me një udhëzues që del nga BE, se si duhet të menaxhohen mbeturinat. Por, KMDK ka aplikuar për leje ne jemi duke i shqyrtuar ato leje, kemi kërkuar kompletim të dokumentacionit, komisioni është duke e shqyrtuar dhe jemi duke parë se a i plotësojnë kushtet për pajisje me këto leje. Kur është bërë plani për të ndërtuar deponitë nuk është studiuar si duhet, pasi që kemi pasur probleme me këto deponi që nga fillimi”, ka thënë Malsiu.

Ndërsa, Abdullah Haxhiu, drejtor i Kompanisë për Menaxhimin e Mbeturinave (KMDK), nuk ka dhënë asnjë përgjigje në lidhje me këtë çështje, edhe pse Preportr ia ka dërguar këtë pyetje dy herë.

Edhe pse në deponinë e

Mirashit që përfshinë rajonin e Prishtinës deponohen më së shumti mbeturina krahasuar me deponitë tjera, aktualisht kjo deponi e ka gjendjen më të keqe. Ekipi i Preportr gjatë vizitës që i ka bërë kësaj deponie, ka vërejtur se kjo deponi nuk ka lagunë fare dhe se ka prani në sasi të madhe të ujit. Kjo gjë është parë si shqetësuese edhe në raportin e KMDK-së, ku thuhet se deponia e Mirashit paraqet rrezik permanent për mjedisin, rrezikim të aseteve shtetërore, por edhe rrezik të madh për shëndetin dhe humbjen e jetës së njerëzve në atë mjedis. Raporti tregon se në këtë deponi rrezik paraqet ngritja e ujërave të zeza, që nëse krahasohet prej vitit 2010, niveli i ujit është ngritur për dy metra. “Kjo ndikon në humbjen e stabilitetit



1 Deponia e Mirashit nuk ka fare lagunë për trajtimin e ujërave të zeza. Afër deponisë ka edhe sasi të madhe të ujit të grumbulluar, i cili ndotet nga ujërat e zeza që lëshohen nga mbeturinat. Ujërat e zeza të kësaj deponie mund të ndotin edhe ujërat nëntokësore.



2 Thasët e mbushur me mbeturina të plastikës dhe kanaçe, të cilat riciklohen nga disa kompani, të cilat angazhojnë punëtorë për t'i mbledhur në deponi.



3 Mungesa e kushteve për trajtimin e eshtrave shtazore nëpër deponi, ka ndikuar që ky lloj i mbeturinave të hedhet afër deponive, pa u groposur fare. Afër deponisë së Podujevës, janë hedhur qentë e vrrarë pa u groposur si duhet.



4 Laguna e deponisë së Prizrenit, që grumbullon ujërat e zeza të cilat i lëshojnë mbeturinat.

të deponive sanitare, zvogëlimin e hapësirës operuese ku mund të vije deri të zhytja e makinerisë dhe rrezikimin e personelit të punë”, thuhet ndër të tjera në raport.

Po sipas këtij raporti, në këtë deponi janë dëmtuar edhe gypat drenazhues për ujëra të bardha dhe të zeza, gjë që po ndikon në përzierjen e këtyre ujërave, pra rritet kapaciteti i ujërave të zeza në lagunë, e që shkakton kapërderdhejn e saj, duke vërshuar ujërat e zeza jashtë trupit të deponisë dhe duke shkaktuar ndotjen e ambientit.

Abdullah Haxhiu përmes përgjigjeve me e-mail ka thënë se pas ndërtimit të kësaj deponie në vitin 2006, pas vetëm një viti të përdorimit të saj, ka ndodhur fundosja e pompave pasi që niveli i ujërave të zeza është mbi 12 metra nën nivelin e ujërave

sipërfaqësor të KEK-ut (Liqenin e Hirit). Haxhiu thotë se në këtë rast kemi të bëjmë me periudhën kur deponia në Mirash dhe deponitë tjera nuk janë menaxhuar nga KMDK, por u janë dhënë në menaxhim operatorëve privatë nga AKM.

“Në i kemi ngritur shqetësimet tona për rritjen e nivelit të këtyre ujërave dhe për shkak të kostonë së lartë, e në pamundësi të vetëfinancimit kemi punuar plane dhe projekte për trajtimin e këtyre ujërave të zeza dhe të njëjtat i kemi adresuar tek institucionet relevante dhe organizata të ndryshme financiare, me qëllim të përkrahjes dhe mbështetjes. Njëri ndër projektet është trajtimi i ujërave të zeza përmes rezervarit të KEK-ut”, thotë Haxhiu.

Ndërsa sa i përket gypave për nxjerrjen e gazit, që kanë

rëndësi shumë të madhe për një deponi, ai thotë se që nga ndërtimi i deponisë në Mirash nuk janë paraparë me projekt gypat që bëjnë ajrosjen e mbeturinave dhe njëkohësisht nuk janë vendosur, ndryshe prej deponive tjera ku janë të vendosur gypat për ajrosje.

Zeqir Veselaj, njohës i çështjeve të ambientit ka thënë se ato ujëra të zeza që derdhen nga deponitë janë shumë herë më të rrezikshme sesa ujërat e zeza të zakonshme, sepse në rastin e deponive ka lëngje të ndryshme, që duke qëndruar në kontakt me shumë materie që janë pjesë e mbeturinave, zhvillojnë shumë reaksione kimike të ndryshme që e rrisin toksisitetin e tyre.

“Prandaj kërkohet që deponitë të kenë izolim për mosrrehjen e ujërave të zeza në deponi dhe t'i kenë lagunat e veçanta për

mbledhjen dhe trajtimin e tyre. Rreziku qëndron se nëse këto ujëra nuk trajtohen me laguna, ato kërkojnë ujërat nëntokësore. Është shumë e dëmshme nëse arrijnë që ato ujëra të zeza të vijnë në kontakt me ujërat nëntokësore, duke e ditur argumentin se një pjesë e madhe e popullatës së Kosovës furnizohet për nevojat e veta me ujëra nëntokësorë”, theksoi Veselaj.

Ndërsa sa i përket çështjes së mungesës së gypave në këtë deponi, Veselaj thotë se ata janë të domosdoshëm për secilën deponi të mbeturinave. Ai thotë se mbeturinat gjatë grumbullimit hyjnë në reaksione kimike dhe lirojnë gazra dhe se gazi më i shpeshtë që lirohet është metani, e që është një gaz i ndezshëm. “Çdo deponi duhet të pajiset me gypa që shkojnë deri në fund të mbeturinave dhe ai gaz të del jashtë dhe kur

del jashtë nuk është i rrezikshëm për eksplodim. Metani i deponuar në mbeturina mund të shkaktojë eksplodim të deponisë dhe e dimë që ka pasur raste nëpër shumë vende që kanë ndodhur këso shpërthime, ndërsa pasojat e shpërthimeve të tilla janë të rrezikshme”, theksoi Veselaj.

Ndërsa Muhamet Malsiu, thotë se në deponinë e Mirashit ka ndodhur një problem i madh, por është paraparë që të sanohet përmes një projekti që do të financohej nga qeveria dhe nga ndonjë donacion ndërkombëtar.

“Situata në deponinë e Mirashit është tepër emergjente dhe është e nevojshme që të intervenohet sa më shpejt. Deponia e Mirashit duhet të ketë në funksion dhe pompat për kthimin e ujërave, përndryshe nuk mund të pajiset me leje”, theksoi Malsiu.

► VAZHDON NGA FAQJA 3

NUK KA KLASIFIKIM TË MBETURINAVE

Deponitë janë duke u mbushur shpejtë edhe për faktin se nuk ka riciklim të mbeturinave në masë të madhe. Vetëm kanaçet, shishet e plastikës dhe qelqi aktualisht riciklohen. Gjithashtu nuk ka ndarje të mbeturinave nëpër kontejnerët e vendosur nëpër vendbanime, e as në deponi.

Zeqir Veselaj, thotë se klasifikimi i mbeturinave në Kosovë është në faza të hershme pasi që nuk kemi sistem për riciklim. Sipas tij, nëse do të ricikloheshin mbeturinat, jetëgjatësia e deponive do të ishte më e madhe dhe nuk do të krijohet nevoja për deponi të reja.

“Edhe nëse njerëzit dëshirojnë t’i klasifikojnë mbeturinat nuk kanë vullnet, sepse edhe nëse i klasifikojnë në kontejnerë, vjen kamioni i ngarkon të gjitha në një vend dhe i dërgon në deponi”, thotë Veselaj.

Mosklasifikimi i mbeturinave sanitare dhe atyre të rrezikshme krijon probleme edhe në të gjitha deponitë, sepse deponitë aktuale nuk kanë kushte për trajtimin e mbeturinave tjera përveç atyre sanitare. Një ndër problemet që hasin deponitë janë eshtrat shtazore të cilat hedhen nëpër kontejnerë dhe pastaj dërgohen në deponi. Abdullah Haxhiu, thotë se në deponitë sanitare konform legjislacionit në fuqi nuk janë të lejuara që të deponohen këto mbeturina. “Megjithatë legjislacioni i jep të drejte MMPH-se që me një vendim të lejojë përkohësisht deponimin e këtyre mbetjeve edhe në këto deponi”, thotë Haxhiu.

Gjithashtu këto deponi nuk pranojnë as mbeturinat e gomave, përveç atyre që u shkojnë si mbeturina, por që përdorën për ndërtimin e lagunave dhe të mureve mbrojtëse të deponive.

MBETURINAT MEDICINALE PËRZIHEN ME ATO SANITARE

Një gjë shqetësuese dhe e rrezikshme është përzierja e mbeturinave sanitare me mbeturina medicinale nëpër kontejnerë. Këto mbeturina jo që nuk duhet të hedhen në kontejnerë nëpër vendbanime, por ato është e domosdoshme që të trajtohen paraprakisht para se të hedhen edhe në deponi të mbeturinave.

Edhe raport i auditimit mbi menaxhimin e mbeturinave medicinale, që është publikuar në muajin gusht 2013, tregon se mbeturinat medicinale shpesh përzihen me mbeturina të zakonshme komunale. Në këtë raport thuhet se transportimi i tyre nuk bëhet me mjete të përshtatshme transportuese, trajtimi final i tyre nuk bëhet në mënyrë të duhur dhe të kontrolluar dhe se menaxhimi i këtyre mbeturinave bëhet në

mënyrë të paplanifikuar.

“Ne arrijmë në konkluzionin se menaxhimi i mbeturinave nuk është duke u bërë në mënyrë të duhur, në atë mënyrë që do të siguronte ruajtjen e shëndetit publik dhe mjedisit, duke çuar rrjedhimisht në kontaminimin e ajrit, ujit dhe tokës. Ne kemi vërejtur se magazinimi i qeseve të mbeturinave ka qenë joadekuat.

Në Kosovë nuk ka deponi për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme, si vajrat e përdorura të automjeteve, bateritë, akumulatorët, mbeturinat spitalore, shtazore, barnat e skedura, ambalazhi i substancave të rrezikshme, mbeturinat e gomës dhe plastikës, mbeturinat elektrike dhe elektronike, pesticidet e skaduara, etj.

“Me deponitë e egra dhe mbeturinat që hedhen afër deponive është dashtë të merren inspektoratet komunale, të cilat kanë të drejtë të shkruajnë edhe gjoba të drejtpërdrejta ndaj personave fizik në vendin ku i hedhin mbeturinat”

Abdullah Haxhiu,
drejtor i Kompanisë për
Menaxhimin e Mbeturinave

Gjatë observimeve tona, kemi vërejtur se mbledhësit e mbeturinave nga klinikat në QKUK (stafi i kontraktuar i kompanisë për pastrim) mbante në dorë pa dorëza mbrojtëse qese plastike të verdha me mbeturina infektive, duke bërë hedhjen e tyre në të njëjtin kontejner ku hidheshin edhe mbeturinat komunale”, thuhet ndër të tjera në raport.

Abdullah Haxhiu, thotë se në të gjitha deponitë ku përgjegjëse për menaxhimin e tyre është KMDK, ky lloj mbeturinave është rreptësisht e ndaluar dhe kjo bëhet përmes kontrollit të çdo zbrazje në sektorin e mbeturinave nga punëtorët përgjegjës të KMDK në secilën deponi.

Ndërsa, Zeqir Veselaj, thotë se mbeturinat spitalore janë të rrezikshme dhe me të gjitha direktivat e BE-së këto mbeturina nuk guxojnë të deponohen në deponitë sanitare, para se ato të digjen në temperatura shumë të larta.

“Trajtimi i këtij lloji të mbeturinave, ndodh pak tek ne, si në QKUK dhe në disa spitale rajonale, por në shtëpitë e shëndetit, këto hedhen tek mbeturinat tjera gjë që nuk guxon në asnjë mënyrë”, thotë Veselaj.

Sa i përket vajrave të automjeteve Preportr ka biseduar me disa autoservise ku bëhet ndërrimi i vajit. Disa nga ata kanë thënë se e përdorin këtë vaj gjatë dimrit përmes disa stufave, ndërsa disa ua shesin kompanive që merren me ndërtimin e rrugëve.

Preportr ka marrë statistikën për importin e vajit që është bërë nga Kosova për tetë vitet e fundit. Sipas këtyre të dhënave, ka një trend të rritjes së importit të vajrave që sillet nga 10 deri në 15 milionë litra ton në vit. Gjithashtu sipas të dhënave që janë marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme, deri në fund të vitit 2013 në Kosovë janë të regjistruara mbi 283 mijë automjete. Këto automjete së paku njëherë në vit e ndërrojnë vajin.

Sipas njohësve të çështjeve të mjedisit, vajrat e automjeteve që janë përdorur duhet të digjen në temperatura tepër të larta nëpër fabrika të veçanta, në mënyrë që të jenë sa më pak të dëmshme për ambientin. Ndërsa në të kundërtën, çdo lloj përdorimi i këtij vaji është i dëmshëm për ambientin. Zeqir Veselaj thotë se ndotja më e madhe bëhet kur vaji i tillë hedhet në ujë. Sipas tij, një litër vaj i përdorur mjafton për t’i bërë të pa përdorshme 100 mijë litra ujë të pijshëm.

RREZIKU NGA PRANIA E PERSONAVE TË PAAUTORIZUAR

Në deponinë e Gjilanit, e cila është hapur në qershor të vitit 2003 e financuara prej BE-së me vlerë prej 3 milionë euro, një gjë shqetësuese është edhe prania e një numri të madh të personave të paautorizuar që mbledhin mbeturina. Pjesë e këtij grupi janë edhe fëmijët, të cilët rrezikojnë shëndetin e tyre duke mbledhur mbeturina gjatë gjithë ditës. Personat që mbledhin mbeturina në këtë deponi, i kanë të ndarë edhe kamionët dhe llojin e mbeturinave që ka për t’i mbledhur secili grup. Gjithashtu një grup i këtyre personave kanë krijuar një ambient me batanije dhe çadra për të fjetur natën dhe që të jenë sa më afër deponisë.

Drejtuesit e kësaj deponie thonë se prania e këtyre personave mund të shkaktojë edhe ndezjen e ndonjë zjarri, pasi që një pjesë e tyre konsumojnë cigare gjatë grumbullimit të mbeturinave dhe se në mbeturina ka gazra që mund të shpërthejnë dhe të përfshijnë gjithë deponinë. Sa i përket pranisë se këtyre personave në deponinë e Gjilanit, drejtori i KMDK-së Abdullah Haxhiu, thotë se është i vështirë pengimi i tyre dhe se për t’i larguar këta persona është kërkuar ndihmë edhe nga Policia e Kosovës.

“Kemi pasur disa takime me policinë në Gjilan dhe ne u jemi drejtuar çdo here policisë përmes shkresave për largimin e këtyre personave, kemi gjetur edhe mbështetjen e tyre. Janë marrë disa aksione. Arsyeya kryesore e rezistimit të këtyre personave për të mos u larguar është shitja e llojeve të veçanta të mbeturinave përmes grumbullimit që ata bëjnë”, thotë Haxhiu.

Ndërsa, në deponinë e Podujevës ndodhet edhe një kontejner me pesticide të rrezikshme, i cili paraqet një rrezik të madh për njerëzit që punojnë aty si dhe për ambientin. Drejtori i KMDK-së Abdullah Haxhiu thotë që nga viti 2005 kontejneri është vendosur nga inspektorati i MMPH-së dhe se KMDK nuk i dinë arsyet e vendosjes së këtij kontejneri, kur dihet se deponia nuk është projektuar dhe ndërtuar për pranimin edhe të këtyre llojeve të mbeturinave të rrezikshme.

“Ky kontejner është i mbyllur hermetikisht dhe nuk ka rrjedhje. Por rrjedhja eventuale mund të dëmtojë ambientin dhe ekosistemin. Megjithatë ne jemi në vazhdimësi duke e monitoruar dhe për çdo rrjedhje eventuale do të njoftojmë organet kompetente”, theksoi Haxhiu.

DEPONI TË EGRA RRETH DEPONIVE

Në të gjitha deponitë e mbeturinave që ka vizituar Preportr, shihet se afër të gjitha deponive hedhen mbeturina nga banorët e fshatrave përreth, duke përfshirë edhe mbeturina të rrezikshme, si eshtra, pajisje elektronike etj, të cilat deponitë aktualisht nuk i pranojnë. Ndërsa shembulli më i keq është afër deponisë së Podujevës, ku përveç eshtrave shtazore të përdorura, janë groposur edhe qentë e vrrarë, e që fatkeqësisht ka gropa të tilla ku këto mbetje të rrezikshme nuk janë të mbuluara si duhet dhe eshtrat e tyre shihen mbi tokë.

Muhamet Malsiu thotë se një nga arsyet e krijimit të deponive të egra, por edhe hedhjes së tyre afër deponive është mosriciklimi i mbeturinave.

“Me deponitë e egra dhe mbeturinat që hedhen afër deponive është dashtë të merren inspektoratet komunale, të cilat kanë të drejtë të shkruajnë edhe gjoba të drejtpërdrejta ndaj personave fizik në vendin ku i hedhin mbeturinat”, thotë ai.

Ndërtimi i deponive rajonale është bërë nga BE-ja dhe ka kushtuar mbi 10 milionë euro. Por, përkundër këtij investimi, asnjë nga deponitë nuk i plotëson kriteret për t’u pajisur me leje mjedisore. Sipas Muhamet Malsiut, drejtor i departamentit për mbrojtjen e mjedisit në MMPH, këto deponi janë ndërtuar pa u bërë një studim i mirëfillt dhe pa u konsultuar me këtë ministri.

Në të gjitha deponitë e mbeturinave që ka vizituar Preportr, shihet se afër të gjitha deponive hedhen mbeturina nga banorët e fshatrave përreth, duke përfshirë edhe mbeturina të rrezikshme, si eshtra, pajisje elektronike etj, të cilat deponitë aktualisht nuk i pranojnë. Ndërsa shembulli më i keq është afër deponisë së Podujevës, ku përveç eshtrave shtazore të përdorura, janë groposur edhe qentë e vrrarë, e që fatkeqësisht ka gropa të tilla ku këto mbetje të rrezikshme nuk janë të mbuluara si duhet dhe eshtrat e tyre shihen mbi tokë.



5

Në deponinë e Gjilanit, janë të pranishëm një numër i madh i personave të paautorizuar që mbledhin mbeturina. Pjesë e këtij grupi janë edhe fëmijët. Personat që mbledhin mbeturina në këtë deponi, i kanë të ndarë edhe kamionët dhe llojin e mbeturinave që ka për t'i mbledhur secili grup.



6

Pamje nga deponia e Podujevës.




7

Një pjesë e deponisë është mbushur me mbeturina dhe është mbuluar, ndërsa pjesë tjetër është duke u mbushur.



LUMENJTË E “VDEKUR”

BESA KALAJA



Një pjesë e lumit të Llapit që kalon nëpër fshatin Bellopojë kundërmon nga shkarkimet që i bën fabrika e vajit “Inter Company”.

**MBROJTJA E LUMENJVE NUK KA QENË
PRIORITET PËR QEVERINË E KOSOVËS.
SHUMË LUMENJ OSE PJESË TË TYRE
NUK JANË TË PËRDORSHËM NGA
DERDHJA E UJËRAVE TË ZEZA OSE
NGA DERDHJET QË BËJNË FABRIKAT E
NDRYSHME. PREPORTR, KA DALË DISA
JAVË NË TEREN DHE E KA PARË NGA
AFËR GJENDJEN E DISA LUMENJVE
SIDOMOS ATYRE QË LLOGARITËN QË
JANË MË TË NDOTURIT.**

Një pjesë e mirë e lumenjve në Kosovë janë të ndotur dhe kjo ka bërë që shumë pjesë të tyre sidomos ato që janë afër zonave të banuara të mos jenë të përdorshëm.

Në Kosovë ka vetëm një implant të ujërave të zeza dhe të gjitha ujërat tjera të zonave urbane po edhe rurale derdhen në lumenj. Gjendja më e vështirë paraqitet me lumin Prishtevka, i cili më shumë i ngjason një kanalizimi sesa një lumi.

Pak më mirë sesa në këtë lum gjendja paraqitet në lumenjtë: Llap, Drenica e Sitnica. Disa lumenj më të vegjël janë në gjendje edhe më të keqe. Preportr, ka dalë në teren dhe për së afërmi e ka parë gjendjen e disa lumenjve, duke identifikuar pika ku gjendja paraqitet më e vështirë qoftë nga derdhja e ujërave të zeza, qoftë nga dredhja e mbetjeve nga fabrika, sidomos ato ushqimore.

Muaj më parë Preportr, ka bërë monitorimin për disa javë të lumit Drenica. Banorët e

fshatrave që jetojnë afër këtij lumi, thonë se ndotja më e madhe vjen kur Ferronikeli e shkarkon ujin, të cilin e përdorë paraprakisht për pastrimin e filtrave dhe ftohjes gjatë prodhimit të nikelit. Sipas banorëve, kur uji lëshohet nga Ferronikeli, ndryshon ngjyrën dhe uji ka temperaturë më të nxehtë.

Zyrtarë të Ministrisë së Ambientit, thonë se lumenjtë janë ende të ndotur, por gjendja po përmirësohet ditaditës. Të njëjtën bindje nuk e ndajnë ekspertët, pasi thonë që Kosova një ditë mund të përballet me institucionet gjyqësore ndërkombëtare nga shtetet fqinje nga ndotja e madhe e lumenjve, pasi të gjithë lumenjtë e Kosovës, duke përjashtuar Ibrin, kanë dalje jashtë Kosovës.

SHUMË NDOTËS, PAK NDËSHKIME

Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, në vitin 2010 ka dalë me raportin “Kadastr i Ndotësve të Ujërave në Kosovë”, ku pas punës disa mujore në teren

ka identifikuar ndotësit më të mëdhenj të lumenjve në Kosovë. Në rajonin e Pellgut të Drinit të Bardhë sipas këtij raporti janë regjistruar 154 ndotës, prej të cilëve 99 janë ndotës kolektiv e 56 individual.

Në Rajonin e Pellgut të Ibrit, Lepencit dhe Moravës së Binçës janë identifikuar 214 ndotës.

Në Pellgun e Ibrit, janë regjistruar 100 ndotës prej të cilëve 75 janë ndotës kolektiv, ndërsa 25 janë ndotës individual. Lumenjtë me numër më të madh të vendshkarkimeve të këtij pellgu janë: Sitnica me 32 pika shkarkuese, Llapi me 22, Drenica me 18, Ibrin me 14, dhe Prishtevka me 7 ndotës, por lumi më i ngarkuar me sasi të shkarkimeve është gjithsesi Prishtevka.

Në Pellgun e Moravës së Binçës dhe Lepencit janë 24 ndotës. Nga lumenjtë më të ngarkuar janë: Morava e Binçës me 14 pika shkarkuese dhe Lumi Mirusha me 8 pika të shkarkimeve kolektive. Në Pellgun e Lepencit lumenjtë më të ngarkuar janë Lepenci dhe Mi-

loshtica, në aspektin e numrit të banorëve që shkarkojnë.

Në Komunën e Prizrenit janë identifikuar 29 ndotës kolektiv dhe 16 individual.

Të gjitha ujërat e kanal-izimeve të qytetit dhe fshatrat

Ministria e Ambientit e pranon se kanë probleme me raste të tilla dhe me rastin konkret.

“Kryesisht kemi probleme me ato fabrika që ndotja e tyre është me influencë më të

portr, ka identifikuar disa raste ku banorë që jetojnë në fshatrat afër këtij lumi pa problem i derdhin ujërat e zeza në lum pa asnjë trajtim paraprak. Banorë të kësaj zone ankohen se në shumë pjesë të lumit më nuk mund të zënë peshk siç kanë bërë më përpara.

Gjendja në lumenjtë e Dukagjinit paraqitet më e mirë. Megjithatë para disa vitesh shtrati i lumit Drini i Bardhë i ishte nënshtruar eksploatuesve të rrës, të cilët megjithatë janë vënë nën kontroll këto vitet e fundit nga Ministria e Mjedisit.

Për lumenjtë e tjerë në të cilët derdhen ujërat e zeza nga fshatrat dhe qytetet e ku disa pika i ka identifikuar edhe Preportr, Bajraktari thotë se janë duke menduar për një zgjidhje më afatgjate e ajo është ndërtimi i impianteve të ujërave të zeza. Në këtë kuptim ai e paraqet gjendjen më shpresëdhënëse duke përmendur edhe shifra që do të ndahen nga donatorët.

“Ministria jonë ka qe tri-katër vjet që ka filluar me ndihmën e donatorëve që të hartojë fazat e para të studimeve të ndryshme për trajtimin e ujërave të zeza, realisht tani jemi në fazën përfundimtare të realizimit të projektit tonë të cilin e kishim prioritet që të bëhet studimi apo fizibiliteti mbi trajtimin e ujërave të zeza, për shtatë qytetet më të mëdha. Prizreni është afër të bëhet me impiant i cili do të kushtojë 22 milionë euro, 5 milionë prej tyre ndahen prej ministrisë”, thotë ai.

Ai përmend edhe tri qytete të mëdha për të cilat mendohet që në të ardhmen të ndërtohen impiante si Prishtina, Peja e Gjakova.

Edhe për keqbërësit e tjerë si për ata që hedhin mbeturina në lumenj dhe ata që bëjnë eksploatim të rrës në ta janë ndërmarrë masa nga Ministria. Duke kërkuar edhe ndihmën e komunave, Bajraktari thotë se do të shqiptohen gjoba për të gjithë ata që hedhin mbeturina në lumenj. Për këtë sipas tij ekziston një udhëzim administrativ.

NUMRAT E NDOTËSVË

Pellgu i Drinit të Bardhë:

ka **154** ndotës:

99 ndotës kolektiv dhe **56** individual.

Pellgu i Ibrit:

ka **100** ndotës:

75 ndotës kolektiv dhe **25** individual.

Lumenjtë me numër më të madh të vendshkarkimeve në pellgun e Ibrit janë:

Sitnica me **32** pika;

Llapi me **22**;

Drenica me **18**;

Ibri me **14** dhe;

Prishtevka me **7** ndotës.

Ndotësit më të mëdhenj të lumenjve:

Derdhja e ujërave të zeza;

Shkarkimet nga fabrikat dhe lokalet e ndryshme shërbyese;

Hedhja e bërllogut.

Pellgu i Moravës së Binçës dhe Lepencit ka:

24 ndotës:

Morava e Binçës me **14** pika shkarkuese dhe;

Lumi Mirusha me **8** pika shkarkime kolektive.

Në Komunën e Prizrenit:

janë identifikuar **29** ndotës kolektiv dhe;

16 individual.

Buxheti total i ndarë për mjedis dhe ujëra:

Në vitin **2010** janë ndarë **4,945,287** euro;

Më **2011** janë ndarë **2,340,000** euro;

Më **2012** janë ndarë **5,015,000** euro;

Më **2013** janë ndarë **6,411,000** euro dhe;

Për vitin **2014** janë ndarë **5,984,684** euro.

Të gjitha ujërat derisa futën në zonat urbane gëzojnë një status të klasit të parë, ku kalojnë në kategorinë e tretë edhe pse disa gjatë rrjedhës së tyre vetvetiu e ndryshojnë gjendjen e tyre kalojnë në një klasë më të mirë.

Naser Bajraktari, drejtor i Departamentit të Ujërave në Ministrinë e Ambientit

e Drenasit derdhen në lumin Drenica. Në këtë lum, sipas raportit, efekt të madh të ndotjes ka Ferronikeli. Qyteti i Gjakovës sipas raportit është i vetmi vendbanim në Kosovë që krahas rrjetit të kanalizimit ka edhe rrjetin e evakuimit të ujërave atmosferik. Në Podujevë nga ndotësit më potencial, është përpunuesi i vajit dhe prodhuesi i lëngjeve “Inter Company”.

Nga bërja publik i këtij raporti që në vitin 2010, gjendja në teren pothuajse nuk ka ndryshuar fare.

Në lumin ku dikur banorët e shfrytëzonin për not e për peshkim, sot derdhet kanalizimi i qytetit të Podujevës. Lumi Llap në shumë fshatra është ndotur nga mbeturinat që banorët i hedhin në të. Një pjesë të tij e ndotë edhe fabrika e vajit që është përmendur në raportin e Ministrisë së Ambientit. Prej atëherë nuk është gjetur një zgjidhje dhe banorët ankohen që gjatë verës duhet të mbyllen brenda nga era që kundërmon nga derdhjet që bën fabrika. Ata thonë se pronarët e fabrikës, viteve të fundit janë pak më të kujdesshëm, pasi mbetjet i derdhin natën, në mëngjes apo kur ka reshje që të mos shihen nga banorët.

madhe dhe në rastin konkret është edhe fabrika e vajit në regionin e Llapit e cila është në procedurë të marrjes së lejes ujore po për shkak të neglizhencës që ka kjo fabrikë po edhe fabrikat tjera nuk janë pajisur të gjitha me leje ujore”, thotë Naser Bajraktari, drejtor i Departamentit të Ujërave në Ministrinë e Ambientit.

Ferronikeli që nga Ministria nuk llogaritet më si ndotësi më i madh i lumit Drenica, sipas Bajraktarit ende nuk ka marrë leje për shkarkim të ujërave. Për ta marrë këtë leje Ferronikeli, është në fazën përfundimtare. Megjithatë gjatë monitorimit disa javor që Preportr, i ka bërë këtij lumi, banorët janë ankuar që ai është i papërdorshëm për shkak të shkarkimeve që i bën fabrika.

Lumi Prishtevka, që përshkon qytetin e Prishtinës dhe del jashtë tij është mbuluar në pjesën më të madhe të qytetit. Në fshatin Bresje lumi ka mbetur i pa mbuluar dhe aty shihet se ai është shndërruar në një kanalizim. Prishtevka, llogaritet të jetë lumi më i ndotur në Kosovë dhe si rrjedhojë i papërdorshëm. Në të derdhet i tërë kanalizimi i qytetit të Prishtinës.

Afër me lumin Prishtevka, është edhe lumi Sitnica. Pre-

► VAZHDON NGA FAQJA 7

RUAJTJA E LUMENJVE NUK ËSHTË PRIORITET I QEVERISË

Bajraktari nuk heq dorë që shumica e lumenjve pa-varësisht që janë të ndotur në disa pjesë të tyre gëzojnë një status të mirë sidomos pjesa e Dukagjinit.

“Të gjitha ujërat derisa futën në zonat urbane gëzojnë një status të klasit të parë, ku kalojnë në kategorinë e tretë edhe pse disa gjatë rrjedhës së tyre vetvetiu e ndryshojnë gjendjen e tyre kalojnë në një klasë më të mirë” thotë ai.

Me këtë konstatim të Bajraktarit pajtohet eksperti i ambientit Zeqir Veselaj. Ai thotë se sa më larg nga burimi i tyre gjendja vjen duke u rënduar sidomos në momentin kur lumenjtë dalin prej vendbanimeve.

“Përgjatë rrjedhës së tyre ata shkojnë duke u ngarkuar me ndotje sepse në njëfarë forme lumenjtë tanë sot janë kthyer në kolektorë mbeturi-nash dhe ujërash të zeza sepse s’ka trajtim të këtyre ujërave”, thotë ai.

Krejt fajin për këtë situatë të krijuar dhe kur Kosova përballat me kapacitete jo shumë të mëdha të ujërave sidomos të atyre që janë të cilësisë së lartë, Zeqiraj ia lë mungesës së investimeve në këtë fushë. Ai thotë se ruajtja e ambientit e në këtë kontekst edhe i lumen-

jve nuk ka qenë kurrë prioritet për Qeverinë e Kosovës. Gjendja sipas tij do të ndryshojë tek atëherë kur investimi në ambient bëhet prioritet siç është bërë asfalti këto vitet e fundit e ku janë shpenzuar qindra- miliona euro.

“Që të dilet nga kjo situatë duhen investime. Investime që BE mund t’i financoje me të ashtuquajturat kredi të buta”, thotë ai.

Sipas informacioneve nga zyra e BE-së në Kosovë, ndihma në fushën e ambientit kap shifrën e 100 milionë eurove.

Zeqiraj është skeptik që projektet për ndërtim impi-antesh do të financohen nga donatorët, “sepse përgjithësisht ato janë projekte që kushtojnë shtrenjtë diku për ta mbuluar Kosovën para disa vitesh një studim fizibiliteti që është bërë për ndërtim impi-antesh është fol një shifër prej 800 milionë eurosh”.

Ai thotë se nuk do të jetë larg dita kur fqinjët tanë Shqipëria, Serbia, Maqedonia do të mund të trokasnin në dyert e institucioneve gjyqësore ndërkombëtare lidhur me cilësinë e ujërave që Kosova i hedh në drejtim të territorit të tyre.

“Kjo mund të ndodhë shpejtë, por kur i flet qeverisë sonë për këto çështje ju duken absurde”, thotë ai.

Projektet më të mëdha që i ka financuar BE janë:

1) Ndërtimi i gjashtë deponive sanitare (Programi CARDS mbi 10 milionë euro);

2) Mbyllja e deponive ilegale;

3) Trajtimi i ujërave të zeza në Skenderaj (Programi CARDS, mbi 2.3 milionë euro);

4) Rrjeti i ujësjellësit në Prishtinë (Programi IPA, 2 milionë euro);

5) Furnizimi me pajisje i Sistemit të Monitorimit të Kualitetit të Ajrit (Programi IPA 2009, 2 milionë euro);

6) Fabrika e Ujit në Shipol (Programi IPA 2008, 2 milionë euro);

7) Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë në Prishtinë (Programi IPA 2010, 11 milionë euro);

8) Fabrika e Ujit në Prishtinë (Programi IPA 2010, 5 milionë euro).



Ndihma e BE-së në Kosovë mbulon një sërë projektesh që kanë të bëjnë me ambientin në një vlerë prej 100 milion eurosh nga programet CARDS dhe IPA gjatë periudhës 2003-2013. Fondet shfrytëzohen për të përmirësuar infrastrukturën e mjedisit dhe për zhvillimin e institucioneve përkatëse.

Zyra për informim të BE-së në Kosovë.



8

Sitnica një prej lumenjve më të ndotur në Kosovë. Në të derdhen ujërat e zeza të të gjitha fshatrave për rreth.



“Ky botim është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society

“Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”. Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e ÇOHU dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.